



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
**Qeveria –Vlada-Government**  
**Ministria e Financave – Ministarstvo za Finansije – Ministry of Finance**  
**Agjencia Qendrore e Prokurimit**  
**Centralna Agencia Nabavke**  
**Central Procurement Agency**

<b>DATE/A:</b>	15.04.2016
<b>PËR/ZA/TO:</b>	Autoritetet Kontraktuese
<b>NGA/OD/FROM:</b>	Mursel Racaj, Drejtor i Agjencisë Qendrore të Prokurimit
<b>TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:</b>	Informim lidhur me zhvillimin e aktiviteteve të prokurimit; furnizim me karburante, furnizim dru , thëngjill, pelet

**Të nderuar,**

Ju informojmë se Agjencia Qendrore e Prokurimit me datën 04.04.2016 ka publikuar Udhëzimin Administrativ Nr. 05/2016 për aktivitetet e prokurimit të centralizuar për nivelin lokal në ueb-faqen e Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik (KRPP) dhe ueb-faqen e Agjencisë Qendrore të Prokurimit (AQP). AQP është përcaktuar që të fillojë me dy procedura të centralizuara .

- Furnizim me karburante
- Furnizim me dru, thëngjill, pelet

Agjencia Qendrore e Prokurimit ka dorëzuar formularin për grumbullimin e të dhënave tek autoritetet kontraktuese të cilat janë në listën e prokurimeve qendrore, sipas Udhëzimit Administrativ nr. 05/2016. Në momentin e njoftimit, ne kemi pranuar edhe disa kërkesa nga autoritetet kontraktuese që nuk janë në listën për prokurime të centralizuara e që dëshirojnë të jenë pjesë e prokurimeve të centralizuara. Të gjitha autoritetet kontraktuese që dëshirojnë të jenë pjesë e prokurimeve të centralizuara për nivelin lokal duhet drejtuar AQP-së me një shkresë, deri me datën 20.04.2016 në ora 14:00

AQP do të zhvilloj vetëm nga një herë aktivitetet e prokurimit (nënshkruaj kontratë) për tri vitet e ardhshme, prandaj cilido autoritet kontraktues që dëshiron të jetë pjesë e prokurimeve të centralizuara duhet drejtuar me shkresë AQP-së deri me datën e lartcekur.

Çdo kërkesë për furnizim që dorëzohen nga Autoritetet Kontraktuese pas këtij afati nuk do të pranohet nga AQP-ja

Në kërkesë duhet që të specifikohen sasi të përafërta dhe vlera e përafërt për 36 muaj.

**Shembull i plotësimit të kërkesës.**

**Logo e institucionit**

**E protokolluar nga kërkuesi – institucioni**

Data	
Për	Zt. Mursel Racaj
Përmes:	
Cc:	
Nga :	
Titulli:	Furnizim me karburante për periudhën 36 muaj (shembull) (vendosni emrin e aktivitetit që dëshironi të jeni pjesë e kontratës te centralizuar )

I nderuar z. Racaj

Në bazë të nenit 95, pika 4 e Ligjit të Prokurimit Publik, nr. 04/L-042 dhe **Nenit 3 pika 4 e UA/05-2016**, përmes kësaj shkrese, kërkojmë që për nevoja të (shëno emrin e Autoritetit Kontraktues) të zhvilloni procedurat e prokurimit për furnizim me karburante, furnizim me dru, thëngjill dhe pelet për periudhën kohore prej 36 muaj. Kontratës ekzistuese afati i skadon me datën ( shëno datën kur i skadon afati kontratës ekzistuese që keni në fuqi).

Formulari për grumbullimin e sasive të përafërta vjetore dhe vlera e parashikuar mund të shkarkohen në ueb-faqe e AQP-së:<http://aqp.rks-gov.net/> ose mund të kërkohet në adresat elektronike:

[Libona.thaqi@rks-gov.net](mailto:Libona.thaqi@rks-gov.net): Furnizim me karburante

[Selma.haxhani@rks-gov.net](mailto:Selma.haxhani@rks-gov.net): Furnizim me dru thëngjill dhe pelet

Kërkesës duhet t'i bashkëngjitet Deklarata e Nevojave dhe Përcaktimi i Disponueshmërisë së Fondeve duke shënuar vlerën e parashikuar për 36 muaj.

Edhe për aktivitetet e tjera të prokurimeve të centralizuara të cilat priten të zhvillohen nga AQP-ja në vitin 2016, mund të na drejtoheni në të njëjtën formë pas publikimeve të njoftimeve paraprake dhe njoftimeve në ueb-faqen e AQP-së.